



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 64, Datë 03.03.2023

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR
PARK 1” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 20 MW, NË
ZONËN E ERSEKËS, BASHKIA KOLONJË, QARKU I KORÇËS**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.03.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 884/1 prot., datë 01.03.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën e Ersekës, bashkia Kolonjë, qarku i Korçës.”,

Konstatohet se:

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 884 prot., datë 17.02.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1 A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “c” dhe “d”; për pikën 2.1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se është plotësuar pjesërisht dokumentacioni si vijon:
 - *Neni 9, Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*
 - **gërma “b”**: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE, Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore (dëshmi penaliteti) për shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k.
 - *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*
 - **gërma “b”**: Shoqëria duhet të përcjellë në ERE letër interesi të rinovuar për mbështetjen financiare, ose të dokumentojë/informojë nëse ka nënshkruar ndonjë marrëveshje me bankën. Gjithashtu, shoqëria duhet të sqarojë mënyrën e financimit në lidhje me shumën totale që disponon në llogari, pasi ajo që ka përcjellë nuk e mbulon të gjithë investimin.
- *Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës*
 - **gërma “c”**: Shoqëria duhet të paraqesë informacion rreth statusit të ecurisë së miratimit të pikës së lidhjes, pasi miratimi i pikës së lidhjes që aplikuesi ka depozituar është miratim vetëm në parim.
- Shoqëria duhet të dokumentojë se ku e bazon deklaratën e saj për jetëgjatësinë prej 35 vitesh të centralit fotovoltaiq.
- Gjithashtu, shoqëria duhet të bëjë me dije mbi fillimin apo fazën në të cilën ndodhen punimet për ndërtimin e veprës.
- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, referuar Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Në kuadër të plotësimit nga Aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.
- Në lidhje me dokumentacionin e konstatuar të munguar, do të njoftohet shoqëria ta përcjellë atë brenda afateve të përcaktuara nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq, me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën e Ersekës, bashkia Kolonjë, qarku i Korçës.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI